



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja (a) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008), nenit 5, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.1 dhe nenit 8 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 6, nenit 8 dhe nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.06.2022 merr këtë:

## V E N D I M

### Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër

- 1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës Nr. 02/2261/22 i datës 10.06.2022 dhe merret vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër nga 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite.**
- 2. Pronat e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 të këtij vendimi janë në Zonën Kadastrale Xërxë, objekt i destinuar për zhvillimin e aktiviteteve biznesore, në sipërfaqe të përgjithshme prej 16219m<sup>2</sup> (gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e nëntëmbëdhjetë metra katror) dhe në shfrytëzim jepet vetëm objekti në sipërfaqe prej 1359m<sup>2</sup> (njëmijë e treqind e pesëdhjetë e nëntë metra katror), i cili gjendet në parcelat kadastrale si në vijim:**
  - 2.1. Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01043-1 në zonën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur Skeja, me kulturë Kullosë e Klasës 3, në sipërfaqe të përgjithshme prej 5016m<sup>2</sup> (pesëmijë e gjashtëmbëdhjetë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit;**
  - 2.2. Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01035-0 në zënën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur Skaja, me kulturë Arë e Klasës 3, në sipërfaqe të përgjithshme prej 2252m<sup>2</sup> (dymijë e dyqind e pesëdhjetë e dy metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të P.SH.E Kosov.K.K.Rahovec-Shfry.N.B.I.Rahoveci;**
  - 2.3. Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01039-0 në zënën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur Skaja, me kulturë Arë e Klasës 4, në sipërfaqe të përgjithshme prej 6506m<sup>2</sup> (gjashtëmijë e pesëqind e gjashtë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit;**
  - 2.4. Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01036-2 në zënën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur Suga-kod puta, me kulturë Arë e Klasës 4, në sipërfaqe të përgjithshme prej 2445m<sup>2</sup> (dymijë e katërqind e dyzet e pesë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit.**
- 3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës, të cekura në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale dhe zhvillimi i**

aktivitetit biznesor dhe tu jepet mundësi qytetarëve të vetëpunësohen, ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.

4. Parcelat e cekur në pikën 1 të këtij propozimi sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01 Nr. 2566 të datës 30.05.2013 ka destinim të përhershëm dhe gjendet brenda Zonës Ndërtimore.
5. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është afatshkurtër në periudhën prej 15 (pesëmbëdhjetë) vite.
6. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t'i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
7. Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi mbi baza mujore, përcaktohet nga komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës sipas vlerës së përcaktuar në Rregulloren 01 Nr. 80/20 e datës 29.06.2020 për Taksa Komunale në Komunën e Rahovecit.
8. Obligohen Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë që të zhvilloj procedurat e ankandit publik në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
9. Obligohet Kryetari i Komunës që pas përfundimit të procedurave të ankandit publik nga Komisioni për zhvillimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale afatshkurtër dhe afatgjatë, të përcaktoj me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim.
10. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.
11. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim lyp në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

**Vendimi u dërgohet:**

- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr- 337/22  
Me datë: 29.06.2022

*Dejtin Kafexhiu*  
Kryesues i Kuvendit

